

KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME
(Lloji kuota)

Sot me date **19.03.2018**(*Mars dymije tetembedhjet*), ditën e hënë, në paletë e mëposhtme redaktuam kontratën si më poshtë vijon.

SHITESI:

Shoqëria **“GOLDEN FARM” sh.p.k.**, regjistruar me numer nipti **L82707202P** me administrator dhe ortak të vetëm; **ENDRIT KRASTA** i biri i Bashkim, i datelindjes 09.10.1979, lindur dhe banues në Elbasan, i identifikuar nga ana ime me letërnjoftimin me numer 027992000 dhe numer personal H91009045Q, leshuar me datë 10.12.2009, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar (më poshtë i quajtur **“SHITESI”**).

BLERESI:

Z.APOSTOL SHELLA, i biri i Thanas, i datelindjes 18.09.1961, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan, i identifikuar prej meje sipas ligjit në baze të letërnjoftimit me numer 027906688 dhe Nr.personal G10918048J, leshuar me datë 20.11.2009, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar (më poshtë i quajtur **“BLERESI”**),

Shitesit dhe edhe blerësit, referuar të dy së bashku do të quhen **“Palët”**.

Të përgjithshme

1. Pala shitese shoqëria **“GOLDEN FARM”sh.p.k.**, përfaqësuar nga **ENDRIT KRASTA** është zotëruar i 1(një) kuote me vlerë 100.000 Leke, që përben **100 %** të kapitalit të Shoqërisë **GOLDEN FARM sh.p.k.**, me seli në Elbasan Shushice VRESHTAJ Fshati Vreshtaj, Elbasan, Rruga Kryesore Elbasan - Gjinar, Godinë 2 Katëshe, Kati 1, Nr.3, përfaqësuar nga **Endrit Krasta** (më poshtë referuar si shoqëria.)
2. Shoqëria është rregjistruar pranë QKR-se si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me **numer nipti L82707202P**, me objekt kryesor *“Krijimi dhe menaxhimi i impianteve të rritjes, përpunimit, thërrjes, ambalazhimit, etiketimit dhe tregtimit të pulave dhe mishit të pulës apo të të gjitha kafshëve, mishit të cilave tregtohet në tregun vendas e të huaj. Pulari për mbareshtrimin e shpendëve, prodhim të produkteve dhe nënprodukteve të shpendëve, incubator, blerje- shitje, Prodhim vezesh, përpunim i ushqimeve për rritjen e mbareshtrimin shpendëve. Tregti me shumicë dhe pakicë, import, eksport, prodhim, shpërndarjen dhe tregtimin e shpendëve dhe produkteve/nënprodukteve të tyre. Krijimin e linjes për rritje e prodhime shpendesh, të nënprodukteve bujqësore e blektorale. Zhvillimi i teknologjive të reja në fushën e rritjes, përpunimit, thërrjes dhe tregtimit të pulave dhe mishit të pulës apo të të gjitha kafshëve, mishit të cilave tregtohet në tregun vendas e të huaj. Import-Eksport i këtyre produkteve, kryesisht pulave të gjalla dhe ato të mishit të pulës, të plotës apo pjese, nënprodukteve të tyre por edhe produkteve të tjera të të gjitha kafshëve, mishit të cilave tregtohet në tregun vendas e të huaj, si psh. mish vici, derri, lope etj., Prodhim, Import- Eksport i nënprodukteve të mishit të të gjithë llojeve të kafshëve si-psh: sallameve, qofteve, kotoletave gjysem të gatshme e të gatshme. Import-Eksport i produkteve me të cilat ushqehen të gjitha llojet e kafshëve, Import-Eksport të makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për impiantet e rritjes, përpunimit, thërrjes dhe tregtimit të pulave dhe mishit të pulës apo të të gjitha kafshëve, mishit të cilave tregtohet në tregun vendas e të huaj. Import-Eksport i makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për prodhimin e nënprodukteve të mishit të të gjithë llojeve të kafshëve si psh.: sallameve, qofteve, kotoletave, gjysem të gatshme etj. Import-Eksport makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për prodhimin e produkteve me të cilat ushqehen të gjitha llojet e*

kafsheve, Furnizimi dhe tregtimi ne pikat e konsumit dhe tregjet e vendit te te gjitha produkteve qe permenden ne objektin e veprimtarise se Shoqerise. Importimi i desifektanteve ushqimore, vaksinave te ndryshme te shpendeve, kafsheve dhe te gjitha produkteve te tjera medicinale te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit te saj primar, rritjes se shpendeve..

3. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijemije) lek.
4. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 45 % të kuotave, nga 100% që zotëron në këtë shoqëri duke qendruar vete pronar i 55% te kuotave, dhe Blerësi dëshiron të blejë sipas kushteve të kësaj kontrate dhe pas kalimit të kuotave bëhen bashkepronare te shoqërisë **“GOLDEN FARM” sh.p.k** , si me poshte vijon:

- a. **ENDRIT KRASTA** **55%** te kuotave
- b. **APOSTOL SHELLA** **45%** te kuotave

5. Në përputhje me nenin 117 pika b “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave”, të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare », neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e shitjes”, dhe në përgjithësi të legjislacionit shqiptar në fuqi, hartohet kontrata e shitjes së kuotave si më poshtë vijon:

6. Shitësi dëshiron t'i kaloje blerësit qe nuk zoteron asnje kuote ne kete shoqeri ,pasi eshte ortak i vetem me 100% te pjeseve edhe 45% te kuotave që zotëron në këtë shoqëri ia shet blerësit Apostol Shella edhe vete i mbetet 55% te koutave ,ne kete shoqeri .-----

7. Në përputhje me “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave”, sipas Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e shitjes ”, hartohet kontrata e shitjes si më poshtë vijon:

Neni 1
Objekti

- 1.1 Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Shitësi i kalon nëpërmjet shitblerjes 45 % ne vleren 45.000(dyzet e pese mije)leke te reja,nga kapitali i zotëruar në shoqëri si dhe të drejtën e pronësisë mbi kuotat dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje Blerësit, duke e garantuar plotësisht titullin e pronësisë të pa rënduar me barrë dhe Blerësi nga ana tjetër blen nga Shitësi kuotat kundrejt një çmimi të përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

- 2 2.1. Çmimi i shitjes eshte **45.000(dyzet e pese mije)leke.**

Neni 3

Pagesa

- 3.1. Çmimi eshte paguar nga Blerësit jashtë zyrës noteriale.

Neni 4

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

- 4.1 Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësi te Blerësi do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe depozitimin e kontratës në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

Neni 5
Garancitë

1. Shitësi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton Blerësin:
2. **5.1.** Se është pronar i vetëm i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e shitura.
3. **5.2.** Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.
4. **5.3.** Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.-----
5. **5.4.** Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

Neni 6
Regjistrimi

Regjistrimi i kalimit të kuotes do të kryhet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 7
Ligji i zbatueshëm


Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jete *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan*.-----

PALET KONTRAKTUESE

SHITESI



BLERESI